

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 176, Qershor 2018


Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

DERI KUR DO RRINË TË NDRYRA SITARËVE VEPRAT E PA BOTUERA TË ATË DANJEL GJEÇAJT

2

Me keq ardhje konstatoj se veprat e dala nga pena e shkëlqyer e At' Danjel Gjeçajt njihen shumë pak nga lexuesit, akoma nuk ka as një analizë dhe vlerësim të mirëfilltë ndërkohë që një pjesë e tyre janë të ndryra në sirtarë.

"MESHARI I KREMTEVE",
Ndonëse i kishte kapërcyer të tetëdhjetat, Gjeçaj bëri gati Mesharin e plotë në gegnisht me dy mijë faqe së bashku me "Rendurin i Meshës" (Mesharin e Përditshëm) më 1970 dhe iu vu punës për përkthimin e plotë të "Testamentit të Vjetër", faqja e fundit e të cilit ndalet tek libri i numrave, përkthyer vetëm pak ditë para vdekjes. Ia doli të përkthente pjesën kryesore të "Biblës".



PSE ËSHTË LËNË NË HIJE GJON MARASHI I BRASHTËS SË SHOSHIT

Padyshim, një nga figurat me aktivitet shumë të gjerë patriotik e atdhetar, me të cilin duhet të krenohet i gjithë Dukagjini, është Gjon Marashi i Brashtës së Shoshit. Shtysë për të shkruar për te, më dha fakti se në dekadat e fundit janë bërë shumë këngë për Shoshin e Dukagjinin dhe megjithëse vargu i njerëzve që përmenden në to është shumë i gjatë, për të cilët nuk jam me dhënë vlerësimin se a e kanë merituar apo jo, nuk përjet kurrkund Gjon Marashi

7



KUSHTRIMI I MEHMET SHPENDIT VJEN NË SHALË: "MALI E BJESHKA NDEZEN FLAKË"

3

"SHALA E LUFTËS DHE E KUVENDIT, / MERR
KUSHTRIM PREJ MEHMET SHPENDIT"

- Nga një këngë popullore -

Pas pushtimit të Shkodrës më 27 qershor 1915, forcat shoviniste malazeze, një pjesë e tyre nën komandën e gjeneralit Radomir Veshoviç u vendosën te Ura e Mesit, me detyrë sigurimin e anës veriore të qytetit si dhe përgatitjen për të sulmuar e pushtuar rrethinat e sidomos malësinë e kryesisht Malësinë e Dukagjinit. Detyrën konkrete e mori brigada e drejtuar nga komandanti i saj Konstandin Nikiç për të sulmuar në momentin e duhur. Planin malazez e morën vesh shaljanët, thotë historiani Pal Doçi. Ata iu vunë punës duke përcaktuar masat përkatëse për të shmangur luftën e në se ajo vjen të përballohet. Shmangia e luftës kërkonte bisedime me palën malazeze, ashtu siç ishte biseduar me Krajlin më përpara, për të shporrur pushtuesin Osman vite më parë.

TURIZMI NUK ËSHTË PRRALLË, POR REALITET, ZHVILLIM

- Mendime -

4

Vitet e fundit po bëhet një punë e mirë për zhvillimin e turizmit në të gjitha drejtimet e tij, si në qytet edhe në ato fshatare, në male apo edhe në bregdet. Sa më shumë rritet niveli, aq më shumë rriten edhe kërkesat për një shërbim më të plotë, më të mirë, më me kulturë, rriten kërkesat për një mundësi informacioni më të kualifikuar, më të sigurt. Kemi parë pritës vizitorësh që u qëndrojnë në këmbë atyre, janë shumë të ndjeshëm në kërkesat e tyre, i trajtojnë si miq dhe jo thjeshtë si njerëz që mund të sjellin të ardhura, por ka edhe raste që vizitorëve u shërbehet sa për formë, dorën e shtrijnë për ti vënë pjatën e sytë i kanë diku tjetër, fytyrëngrysur, ...

AKULLORE FEST - 5

Festivali lokal për fëmijë "Akullore Fest" në Shkodër festoi 5-vjetorin e tij!
"Akullore Fest", ky festival i mrekullueshëm i këngës për fëmijë në Shkodër, sivjet në këtë fillim vere mbushi 5 vjet, si një vogëlushe e bukur, që dalëngadalë iu afrua kështu edhe moshës së artistëve të vegjël pjesëmarrës, pasi edhe ata në përgjithësi tani tashmë moshave shkollorë të të dy cikleve.

8



DERI KUR DO RRINË TË NDRYRA SITAREVE VEPRAT E PA BOTUERA TE ATE DANJEL GJEÇAJT

Me keq ardhje konstatoj se veprat e dala nga pena e shkëlqyer e At' Danjel Gjeçajt njihen shumë pak nga lexuesit, akoma nuk ka as një analizë dhe vlerësim të mirëfilltë ndërkohë që një pjesë e tyre janë të ndryra në sirtarë.

“MESHARI I KREMTEVE”,

Ndonëse i kishte kapërcyer të tetëdhjetat, Gjeçajt bëri gati Mesharin e plotë në gegnisht me dy mijë faqe së bashku me "Rendorin i Meshës" (Mesharin e Përditshëm) më 1970 dhe iu vu punës për përkthimin e plotë të "Testamentit të Vjetër", faqja e fundit e të cilit ndalet tek libri i numrave, përkthyer vetëm pak ditë para vdekjes. Ia doli të përkthente pjesën kryesore të "Biblës".

Në këtë përkthim shkëlqen për mjeshtri të madhe. Përktheu edhe një nga copat më mahnitëse të mbarë letërsisë botërore "Kanga e Kangëve".

Prej "Testamentit të Ri" përfundoi "Punët e Apostujve" e copa të tjera të rëndësishme. Nga gjithë ky material voluminoz me mijëra faqe, mundi të botojë vetëm librin e "Psalme" më 1999, duke lënë pas në duart e bashkëpunësorëve të vet besnikë pjesën tjetër që, me siguri, do të botohet së shpejti. Në të kundërt do të ishte shkelje e amanetit, por edhe një humbje e madhe për kulturën shqiptare.

At Gjeçajt vdiq me një brengë të thellë në shpirt që "Meshari" i përkthyer aq mjeshtërisht nuk e pa dritën e botimit, vetëm se qe përkthyer në dialektin gegënisht. "Nëse vullnesa e Zotit është që të vdesë gegnishtja, le të vdesë me një Meshar, ashtu si me një Meshar patilindur."

“DIKUR NË DUKAGJIN”,

Nga ky libër janë shkëputur librat me portrete tashmë në qarkullim "Prel Tuli i Salcës", "Mehmet Shpendi e Mark Sadiku i Shalës" ka mbetur akoma dorëshkrim "Tre të Shoshjanët e Besës" Botimi i këtyre librave është mundësuar nga të afërmit e këtyre figurave të cilët duhej të ishin treguar më dore lëshuar duke mos e ndarë dorëshkrimin e sikur të ishte pite.

“TRE TË SHOSHJANËT E BESËS”

U kushtohet patriotëve Mark Milani, Babun Celi dhe Zef Delia.

Libri mbështetet mbi një ngjarje faktike të njohur historikisht, të kthyer në baladë dhe të kënduar madhueshim në zharkun e lahutës. Fati i jetës së këtyre fatosave kalon përmes llogoreve të lara me gjak nga breshri i gjyleve të Turgut Pashës dhe Vashoviçit.

Nuk u ndalën mes fishkëllimës së plumbave të serbit e nemsës nëpër prita, qafë rrabe e lisa.

Fjala zjarr dhe zemra çelik ju mburojë në përleshje prita e ngujime.

Mëkati i tyre i vetëm ishte se morën

anën opozitës së Guarkuqit dhe Bajram Currit, prandaj morën të njëjtin ndëshkim si ata nga dora gjakatare e sundimtarit të pamëshirshëm Ahmet bej Zogolli.

Tipari karakteristik i përbashkët i tyre ishte burrëria dhe besa e pashoqe që i bëri të pavdekshëm. Në librin e tij Gjeçajt trajton kryesisht vetëm aktin final që ka të bëjë me një sfidë të përmasave legjendare. Të arrestuar tradhëtisht dhe të dënuar padrejtësisht me litar, natën që do vareshin, thyejnë burgun. Gjatë kërcimit nga kati i tretë, Zef Delia thyen shtyllën kurizore. Duke i qëndruar stoik besës që i kishin dhenë shoqishoqit, Mark Milani kthehet dhe merr në sup shokun e lënduar për vdekje.

- Burra! - tha me gjysmë zëri. - Puna eme e pat. Zoti ua bafte udhën e mbarë. Jam t'ue zgjidhë prej besës së dhanë, pshtoni ju e më lini të vdes në këtë vend, se nuk keni kurrëka me më ba.

- Mos e thashtë zoti me të lanë vetëm e me koritë vetin e tanë fisin.[1]

Martin Marashi, ortaku i tretë i prangave, nuk do të largohet, por urdhërohet nga Marku të shkojë dhe t'u tregojë shokëve të vet namin lanë në Shkodër. Mark Milani, në pamundësi të largohej prej Shkodre me një vigan dy metrosh në sup, u drejtohet xhandarëve:

- Të vdekur se vdekur ishim. Nuk paska qenë fati ynë me shpëtue. Ne bamë tonën, ju bani tuajën, - dhe shkoi së bashku me shokun e vet drejt e në litar.

Përmes tregimit të tij historik, Gjeçajt materializon në mënyrë konkrete kultin mitik fjalës së dhënë. Kjo fjalë e veçantë nuk ekziston në shumicën e gjuhëve të botës, ndërkohë që në Shqipëri është sinonim i nderit, madje, më shtrenjtë se jeta, ndërsa në Dukagjin ka homeridë të tillë, para të cilëve përulen legjendat e moçme. Gjeçajt në libër konkretizon më së miri se ky kult madhështor ruajt gjurmën e burimit tek shqiptarët.

Libri është një elegji dhimbjeje trishtuese, duke na kujtuar se politika shqiptare bëri më dëme se kolera dhe se prej pushkës së dreqagës së politikës janë rrëzuar lisat më të mirë burrërimin dhe atdhetarisë.

Nga njëra, në libër Gjeçajt thërret me dihatje:


- Qani, ju malet e Shqipnisë! Qani, sidomos, ju malet e Dukagjinit! Qani ju, o popull malësor që ua vranë lulen e bur-

rimit sikur të ishin katila!

Në planin tjetër, libri Gjeçajt është një buqetë trëndafilore mbi varret e fatosave të besës, është një zemrek me gurë të çmuar që nuk ndryshket nga harresa mospërfillëse as vargu i moteve që nuk ndalen.

“SYKË KOLJA”

“Sykë Kolja” është një romancë historike e mbetur në dorë shkrim e at' Danjel



Gjeçajt

E veçantë në llojin e vet dorëshkrimi origjinal ka 100 flete format A4 te shtypura ne makine

Ngjarjet dramatike zhvillohen në harkun e viteve 1900-1910.

Autori më guxim si pak klerik trajton temën gruas që shihej si tabu dhe hermetizëm i pa përshkueshëm në një shoqëri totalitare maskiliste

“Sykë Kolja”[2] vjen nga pena e Gjeçajt si sinonim i bukurisë më rrezatues inteligjencës më të lartë femërore të kohës, fisnikërisë me të bilurte, dhe mirësisë më të çmuar njerëzore.

Gjithë subjekti i romancës përshkruhet nga lufta mes virtyti dhe vesit, të mirës dhe së keqes, despotizmi mashkullor dhe qëndresë durimmadhe te femrës nën qelin zyrtë të zakoneve të ngurrëta dogmatike ku femra ishte në qenie memece, që

duhej bindur me përlulje vullnetit prindit, vëllait burrit madje kur viste burri edhe kunati dhe meshkujve të tjerë të shtëpisë

Syka martire e amshuar e virtytit femërore, shitohet në mënyrë shtazore nga vesi kapriços i një mëkatari të madh si Shytan Nika që mbante në shtëpi një grua pa kurore në kundërshtim perpendikular moralin kristian të maleve të Lekës.

Sikur të mos mjaftonte kaq pas vdekjes se vëllait Shytani i dehur nga bukuria magjepse e Sykës shkallmon duke tentuar te marre si grua te dyte. Te Shytan Nika përfaqësues i pa denjë i një dere të njohur të një fisi parik të Shalës në dualizmin mes moralit kristian dhe dëshirave të pa përmbajtura pagano-orientaliste fiton kjo e dyta e cila e shpërfytyron vrasje të ndjenjave më sublimeve. Vepra shigjeton me drejtësi hyjnore anët më të errëta te shoqërisë se atëhershme patriarkale, të cilën ose nuk e njohim, ose hipokrizish nuk duam ta njohim se kemi frike te përballemi dhe çfarë është më skandalozja jo pak nga ne e veshim me xhubletën e visaret të traditës. Flijimi engjëllorë i Sykë Kolës, rezon mitin të jo pak heronjve të epikes së patriarkatit absolutist. Nëse “Tre të Shoshjanët e Besës” do të botohen këtë vit me kontributin tim, ndërsa botimi i romancën historike “Sykë Kolja” do ishte në nderin e ço kontribuuesi dukagjinas dhe jo dukagjinas. Shoqata Atdhetare “Dukagjini” ka bere shumë punë të mira me kosto akoma edhe më shtrenjtë, prandaj do sugjeroja të përpiqemi që këtë vepër ta nxjerrim nga kyçi

i sirtarit të vjetër At'Gjeçajt, që beri aq shumë për kulturën dhe Dukagjinin e tij dhe mori aq pak për vete.

PRELË MILANI

[1] At Danjel Gjeçajt, Tre shoshjanët e besës, dorëshkrim.

Arkivi Gjeçajt, depozituar në Bibliotekën Françeskane Shkodër.

[2]. Arkivi i Bibliotekës Françeskane Shkodër Dorëshkrimi origjinal “Sykë Kolja”Romance historike rreth viteve 1900-1910, fq , 66 Personazhi kryesore Syka është vajzë Shoshi, e martuar në Shalë sipas zakonit me shkuesi pa përfilur fare dëshirën e vajzës

KUSHTRIMI I MEHMET SHPENDIT VJEN NE SHALE: “MALI E BJESHKA NDEZEN FLAKË”

“SHALA E LUFTËS DHE E KUVENDIT, / MERR KUSHTRIM PREJ MEHMET SHPENDIT”

- Nga një këngë popullore -

Pas pushtimit të Shkodrës më 27 qershor 1915, forcat shoviniste malazeze, një pjesë e tyre nën komandën e gjeneralit Radomir Veshoviç u vendosën te Ura e Mesit, me detyrë sigurimin e anës veriore të qytetit si dhe përgatitjen për të sulmuar e pushtuar rrethinat e sidomos malësinë e kryesisht Malësinë e Dukagjinit. Detyrën konkrete e mori brigada e drejtuar nga komandanti i saj Konstandin Nikiç për të sulmuar në momentin e duhur.

Planin malazez e morën vesh shaljanët, thotë historiani Pal Doçi. Ata iu vunë punës duke përcaktuar masat përkatëse për të shmangur luftën e në se ajo vjen të përballohet. Shmangia e luftës kërkonte bisedime me palën malazeze, ashtu siç ishte biseduar me Krajlën më përpara, për të shpurrur pushtuesin Osman vite më parë.

Për të zhvilluar bisedimet u përzgjodh një përfaqësi nga Shala e përbërë nga katër burra të shquar për trimëri e mençuri, për gojëtarë dhe vendosmëri, dhe konkretisht Mehmet Shpendi, udhëheqës i shquar i “Djelmnisë së Shalës”, dy burra të tjerë të njohur si bashkëluftëtarë të Mehmet Shpendit, Çun Nika e Marash Delia nga fshati Nica-Shalë, krahë të fuqishëm të Djelmnisë. Në përfaqësinë e re u bë pjesë e saj një burrë, më i ri në moshë se të parët, por i njohur për trimëri e mençuri Dedë Lulash Perani nga fshati Lotaj, i provuar në fushën e luftës por edhe në pleqëri e kuvende burrash, brenda dhe jashtë fisit.

Pa humbur kohë përfaqësia, pasi bëri përgatitjet e nevojshme dhe u dakortësuan për të vazhduar përgatitjet për luftë në se nuk japin rezultat bisedimet, morën kontakt me gjeneralin Vashoviç në komandën Malazeze. Gjenerali kishte qënë prezent në takimin e parë me Krajl Nikollën, për arsyen se ai dinte shqip dhe hiqej si mik i shqiptarëve. “Buzëqeshja” hipokrite e tij ishte një mashtrim për mundësinë e takimit me Krajlën, ndonëse u premtoi se kur të shkonte në Cetinjë do ta takonte dhe deri sa të ktheheni ju nga takimi nuk do të lëvizim në drejtim të Dukagjinit. Sorollatjet sa në Cetinë e sa në komandën e forcave pushtuese, që i bënë përfaqësues të tonë, treguan pabesinë dhe natyrën agresive e mashtruese për pamundësinë e takimit që ishte premtuar. Ata menduan që me sorollatjet të fitohej kohë për të mbërritur në Dukagjin brigada e komanduar nga Konstandin Nikiç. Në plan, atje ku ishte vendosur brigada, pasi i lidhen pjesëtarët e përfaqësuesit e çuan atje për ti keqtrajtuar herë më këmbë e herë me kulaç. Në këtë mënyrë shkelën të drejtën ndërkombëtare mbi negociatorët të cilët në asnjë rast nuk mbahen si pengje siç u bë me përfaqësinë tonë nga malazezët, për luftë a për paqe,

sepse si njëri si tjetri

At Daniel Gjeçaj e quan ditë të zezë atë ditë kur pritej të merreshin vendimet e fundit, sepse si njëra si tjetra vareshin prej pengjeve, nga qëndrimi i tyre, ose të çohet lajmi në Shalë që të dorëzonin armët dhe qafat, ose lufta ishte e shpallur dhe jeta e tyre u shkuar. Mehmet Shpendi i dihej fjala. Ai foli pasi shikoj rrefshëm shokët për tu kuptuar mendjen dhe vendosmërinë e tyre, duke u dhënë përgjigjen pushtuesve “jemi të gatshëm një mijë herë me dekë se me tradhtue”. Bisedës me gjeneralin po i vinte fundi. Heronjtë tanë nuk mendonin më për jetën e tyre, por vetëm për Shalën e Dukagjinit. “Ne të dekun se dekun jemi, duhet gjetur rruga për të çuar fjalën në Shalë, kushtrimin për luftë”. Kur ata, secili, po mendonte se si të bënin, vjen propozimi i gjeneralit për të zgjedhur Mehmet Shpendi një nga shokët e tij me çue fjalë Shalës që të lëshojnë qafat e maleve dhe të dorëzojnë armët. Mehmeti edhe në këto kushte nuk e humbi drejtpeshimin sepse luhej midis vdekjes dhe tradhtisë. Shala duhej lajmëruar që të mos kapej në befasi. Atëherë ai mori vendimin dhe caktoi Dedë Lulashin që të çonte fjalën në Shalë. Deda ishte më i riu dhe më i shpejti, por edhe babë i dhjetë fëmijëve. Shko Dedë, në emrin tonë, thuaj Markut (Sadikut) dhe bajraktarëve të lëshojnë qafat e maleve dhe të dorëzojnë armët. Këtë moment e përcjellë bukur poeti Prelë Milani:

“...Thërret Dedë Lulashin afër vetit,
Të kam shok e të kam si djalë,
Ik e shko me vrap në Shalë,
Thuaj Shalës e shokëve të mijë,
Na kanë lidh në pabesi,
Edhe pse të tre do të vdesim,
Truall e vend të mos i shesim”...

Pikërisht ky moment ishte tepër vendimtar, përcaktues. Mehmeti ishte i merakosur për rolin e Dedës, në se do të kuptonte fjalët që ai tha përpara gjeneralit, në ndryshim me to a e shikonte lëvizjen e gishtin e këmbëzës së pushkës poshtë gjunjëve ashtu siç ishte i lidhur. Pikërisht për këtë ishte zgjedhur Deda, si mendje hollë që ishte. Lëvizja e gishtit të këmbëzës kishte domethënie e vërtetë që Shala duhej të luftonte. Dhe kështu u bë pas mbërritjes së Dedës në Shalë, “bjeshkë e vërrin morën flakë”.

Pas largimit të Dedës gjenerali, i bindur për suksesin, i drejtohet Mehmetit:

- Shala po i dorzon armët, pra u dorzua.
- Besa jo, ia kthen Mehmeti i kthen përgjigjen, djem e Shalës e kanë at zemër sa me i mbrojtë trojet e veta.

Po kush ishte Dedë Lulash Perani i Lotajve?

Deda ishte një burrë i shquar për trimëri e mençuri. Ai u lind në fshatin Lotaj rreth vitit 1870, në një familje me tradita patriotike, me dashuri e përkushtim për njerëzit, për familjen, për fshatin, për fisin. Ai u rrit e u formua duke dëgjuar e më vonë si pjesëmarrës aktiv në pleqni, në kuvendin, pajtime dhe zgjidhje konfliktesh të ndryshme si dhe më tej gatishmëria për të luftuar e dhënë edhe jetën për lirinë e paprekshmërinë e trojeve tona ishin prova të vërteta për këtë burrë, i cili u bë simbol që populli i këndoj veprës së tij “si burrë daji”.

Kjo rrugë e jetës së tij, e bëri atë të njohur, bënë që ai të zeje vend nderi të merituar, prandaj dhe Mehmet Shpendi e zgjodhi nga “Djelmnia” për zgjuarsinë e tij natyrale, i përkushtuar për nderin e fisit, për nderin e Shalës.

At Daniel Gjeçaj në librin e tij “Mehmet Shpendi e Mark Sadiku i Shalës” na jep portretin e Dedës; të njëjtit syni në të, mos me e vra për gjak, i hjetllë shtatit, gjakthjellë, flokë rrupç që i derdheshin ambël në njanë anë të ballit. Rrypi i fishekëve, alltia e ngrimë në serm, i ngjiteshin trupit të tij ende në të mbushun, e bajshin ma të pashëm e tërhjekës”.

Deda nuk u ndodh rastësisht i prangosur, i keqtrajtuar, i torturuar, ashtu si edhe shokët e tij pengje në duart e komandës famëkeqe e gjakatare, masakruese e hakmarrëse malazeze. Edhe Deda e pa vdekjen me sy, sepse mbi atë dhe shokët u derdh pa mëshirë tortura ç’njerezore, për ti gjymtuar e gjuhëzuar fizikisht dhe moralisht. Por, qëndrimi burrnore i papërkulur i heronjve tanë i tërbonte bishat me fytyrë njeriu aq sa u lodhën e durimi i tyre mori fund pikërisht atëherë kur iu dhe fjalën e fundit Mehmet Shpendit të zgjidhte midis jetës apo vdekjes. Jeta ishte garantuar po të tradhtohet Shala. Jo, dhe vetëm, jo, mendonte Mehmet Shpendi, vdekja është kapak floriri.

Por, siç u tha më lart, dhe mençuria e Mehmetit, përkushtimin e tij deri në vdekje për Shalën, krijuan mundësinë që Deda ta vazhdonte jetën, duke dalë nga kthetrat e vdekjes, si më i riu e me këtë me çua kushtrimin e luftës për lirinë e Shalës. Po si e priti Deda këtë mundësi? Me dhimbje të thellë, me pikëllim të madh për shokët, ai nuk lëvizte nga vendi, por mendonte se po linte shokët. Mehmeti e kuptoi gjendjen e vështirë të Dedës, por në mënyrë të prerë i tha: “Shko sa ma shpejt në Shalë, ne të mbaruem se të mbaruem jemi”.

Populli me këngën e tij i ka përjetësuar këta heronj që dhanë gjënë më të shtren-

jtë, jetën e tyre, për Shalën, për nderin dhe lirinë e saj. Edhe pse Deda ishte gjallë kur Shala ishte në zi për udhëheqësit e heronjtë e saj, kënga i thuri lavdi edhe Dedës si “trim daji”. Mesazhi i fundit që përcolli Mehmet Shpendi me anën e Dedës për Shalën ishte:

“...Dukagjini shpi për shpi,
Digju e piqu për liri,
Si në kohën e Kastriotit,
Vdesin prap shqiptarët e sodit...
...

Thoni Shalës mos të më kjajnë mue,
Por të kjajnë veten se ka mbarue...”

Dedë Lulashi jo vetëm për veten e tij u bë simbol i luftës për liri, për nderin e Shalës si pjesëtar i nderuar i “Djelmnisë” të saj, por edhe për djemtë e tij, Zymeri, Nika e Lulashi e vazhduan rrugën e babës, jo vetëm në Qafën e Agrit, e më vonë djali i tij, Mushaku u bë një luftëtar i vendosur e pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacional Çlirimtare, i inkuadruar fillimisht në Çetën Partizane Të Dukagjinit, e më vonë në Batalionin partizan “Perlat Rexhepi” bashkë me bashkëfshatarët e tij Market Pjetra e Martin Gjoni.

Nderi i Dedës u ngrit edhe më lart nga rrethi i gjerë familjar e miqësor që erdhi nga djemtë e tij Zymeri, Nika e Mushaku, lidhjet miqësore të të cilëve ishin plot nderë e burri për truallin e Dedë Lulashit, me djemtë e vajzat e tyre që kanë nderuar edhe fshatin tonë. Po kaq nder e burri çuan edhe gjashtë vajzat e Dedës në ato familje ku shkuan në Shalë e në Shosh. Miqësia e madhe, e zgjedhur dhe e nderuar ia shtoi madhështinë Dedë Lulashit. Jo vetëm familjarët, nipa e mbesa e tij por edhe ne, bashkëfshatarët e tij jemi krenar për këtë luftëtar të shquar, që e ka përfaqësuar kudo e kurdoherë fshatin tonë, me nderë e dinjitet, ashtu si dhe shumë bijë të tjerë, të vjetër e të rinj, duke u vënë në ballë e në presidiumin e nderit emrin dhe veprën e Dedë Lulashit të Lotajve.

Vendlindja ime e dashur, për ty kam bërë shumë pak edhe pse jam përpjekur të të lartësoj emrin. Ky shkrim për Dedë Lulash Peranin, është pak, por të jap fjalën se sa të jem gjallë nuk do të resht së shkruari, për bijtë e tu. Këtë radhë po e mbydhë shkrimin tim me vlerësimin që bën poeti Agim Vinca nga Struga “Njeriu i shkretë sado moshë e përvojë që të ketë, para nënës dhe vendlindjes mbetet gjithmonë fëmijë, e shumta adoleshent”.

Ndoc GRIMAJ

PROMOVIMI I LIBRIT “ANTALOGJI-GEGNISHTJA POETIKE”


“Instituti i promovimit të vlerave në Gjuhën Shqipe”, në kuadrin e veprimtarive të “Pro Gegnishtes” organizoi në qytetin e Shkodrës promovimin e një antologjie: “Antologji, Gegnishtja Poetike” me autor Filip Guraziun, ku mund të përmendim se është një nga kryetaret që bashkia e Shkodrës ka pasur nder vite. Promovimi ka qenë mjaft serioz në kinema “Mileniumi” që tërhoqi jo pak interes.

Në këtë veprimtari ishte e pranishme edhe kryebashkiakja e bashkisë, zonja Voltana Ademi.

Autori foli rreth këtij libri, duke treguar vlerat që ky botim përmban dhe rëndësinë që ky botim ka për gegnishten dhe gjuhën shqipe në tërësi, pjesë e historisë letrare të së cilës është edhe gegnishtja.

Kongresi i vitit 1972 që njihet si “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe” dyzoi Shqiptarët! u shpreh Guraziun, i cili e quajti si “kongres famëkeq” sepse humbi gjuhën standarde të Shqiptarët. Materi-

alet e këtij kongresi dhe vendimet e marra janë të botuar në librin “Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe” (1972), libër që shërben si bazë e studimit të “Praktikum i Gjuhës



Shqipe” në fakultetin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë që çdo Universitet ka.

Në këtë libër autori ka përzgjedhur poezi prej 35 autorëve të njohur dhe jo shumë të njohur për publikun, të cilët shkruajnë në gegnisht në grupin e “pro Gegnishtes” në Facebook, natyrisht, ashtu siç pohoi edhe vetë autori Guraziun, pa ndihmën e këtij rrjeti social nuk do të ishte realizuar botimi me poezi që ky libër përmban.

Të pranishëm ishin edhe disa nga autoret e poezive që mbajtën fjalën përshëndetëse duke falënderuar autorin për mundësinë e këtij bashkëpunimi.

I pranishëm ishte si redaktor artistik i librit, autori i njohur i disa veprave Primo Shllaku, dhe në fjalën e tij përshëndetëse për të ftuarit i dha “një shuplake” të gjithë atyre që duan ta harrojnë gegnishten dhe për të rinjtë, që të mos e ndryshojnë dialektin, që për përshkruar situatën th, se çdo gjë lind e vogël dhe rritet e madhe, i vetmi

që lind i madh dhe vdes i vogël është qiriu, duke i dhënë një motivim brezave të rinj të shkruajnë gegnisht, të shkruajnë në dialektin e gjuhës së nanës.

Promovimi i këtij libri mbart edhe një qëllim të veçantë në vetvete, i cili bëhet në vijimin e përpjekjeve për kultivimin e gegnishtes, një mision që e kanë ndërmarrë shumë figura të njohura.

Veprimtaria, në mbyllje të tij dha dy çmime të rëndësishme çertifikata, diploma si vlerësim për punën e bërë, vlerësime këto të dhëna nga “Instituti i promovimit të vlerave në Gjuhën Shqipe”. Vlerësimi i parë iu dha kantautorit të njohur Gjokë Vatës, për promovimin dhe ruajtjen e vlerave të gegnishtes në krijimet e tij, dhe vlerësimi i dytë ishte për autorin e librit Filip Guraziun, si një nga promovuesit më të mirë të gegnishtes në rrjetet sociale.

Në mbështetje të veprimtarisë ishin të pranishëm edhe nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, kryetari i saj Ndue Sanaj, sekretari i saj, Luigj Shyti; Anëtar i Nderit të Shoqatës, Gjergj Preluca dhe Ahmet Osja; anëtarja e shoqatës, Klodjana Serraj.

KLODJANA SERRAJ

TRI MREKULLI SHKODRANE NË TRADITAT E SHQUARA SHQIPTARE

Duke pasur frymëzim për traditat e shkëlqyera të arsimit shqiptar por njëkohësisht edhe të futbollit shqiptar, në këtë nostalgji, i prekur nga vitet hyjnore dhe rinore, në lagjen time të lindjes, Kiras, do shprehi një të vërtetë historike për zhvillimin e arsimit në përgjithësi por edhe atë të Shkodrës, qytetit tim në veçanti. Vërtetë Shkodra është simbol i kulturës dhe i rilindasve të mëdhenj Pashko Vasë Shkodrani, Filip Shiroka, Gjergj Fishta, së bashku me mësueset e popullit Luigj Gurakuqi, Migjeni, Shaban Arra etj, etj, deri në ditët tona, na detyron të themi se mësuesat e popullit janë rrezatim dhe frymëzim i vazhdueshëm për qytetin tim dhe për të gjithë kombin shqiptar. Unë shpesh në 7 mars vendosi lule tek busti i mësuesit të popullit Luigj Gurakuqi, tek busti i Migjenit dhe tek shumë të tjerë... Por sot unë kam ndër mend të vendos një buqetë kujtimesh për figurën e mësuesit të thjeshtë shkodran, duke përcaktuar vlerat e tij edhe në lagjen historike të qytetit të Shkodrës që quhet “Dudas”. Kjo lagje 500 vjeçare ka një rrugicë që qendër të lagjes, që quhet rrugica “Balaj”, që kur i numëron dyert e vogla të saj nuk janë më shumë se 8 por aty që nga viti 1936 kanë dalë 24 mësues shumë të njohur për Shkodrën dhe për Shqipërinë si Jonuz Bala, Eljaz Kraja, Isa Hoti, Xhevat Kraja etj. Kjo rrugicë më ka frymëzuar për të bërë edhe një montazh televiziv me një skenar të thjeshtë duke theksuar se mund të jetë rrugica kampion në numrin e mësuesave duke ja kaluar të gjithë qyteteve të Shqipërisë edhe të Elbasanit dhe të Gjirokastrës. Edhe unë ruaj kujtime në këtë rrugicë sepse në vitet 1958 – 1959 shkoja shpesh tek shtëpitë e mësuesave

kur asokohe unë isha nxënës në 7 vjeçare. Për këto 24 mësues kanë shkruar edhe shumë të tjerë, në veçanti për mësuesin e paharruar të gjuhës Eljaz Kraja. Për këto mësues është detyrimi jonë që të dalin më në pah vlerat e tyre të punës edukative mësimore që kanë bërë për dekada të tëra.

Por ky frymëzim për mësuesin më bëri që të ndalem në një fakt real por që është një e vërtetë e madhe ku në një shtëpi të fisit “Quku” të lagjes Fahri Ramadani të Shkodrës kanë dalë 25 mësues të profileve të ndryshme, në veçanti të matematikës. Këto mësues si Gani Quku, Refik Quku, Ali Quku, Oso Quku etj, etj janë bërë të njohur në të gjithë vendin tonë për kontributin e tyre modest në fushën e arsimit. Kështu Oso Quku në vitet 1951 – 1952 ka pasur nxënës në klasë të parë Sali Berishën në shkollën fillore Viçidol, Tropojë. Ai ruante kujtimet shumë të mira për rrethin e Tropojës.

Në lagjen Kiras ku historiku i futbollit është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me futbollistat e mëdhenj të kombëtares shqiptare të vitit 1946, ku 5 prej tyre janë kirasjanë, më bëri mua që të fiksoj një fakt të rradhë për futbollin shqiptar dhe botëror, ku në një rrugicë me 7 dyer kanë dalë 7 lojtarë të Vllaznisë, ku 5 prej tyre kanë qënë dhe të kombëtares, dhe këto janë Ahmet Nuti (Shpuza), Xhevat Basha, Ismet Hoxha, Zyhdi Basha, Luan Shpuza, Lutfi Basha dhe Çlirim Basha. Në fakt për momentin e parë duket si e pabesueshme, por kjo është një e vërtetë për të cilën Kirasi historikisht është krenuar për talentet e fut-

bollit që ka nxjerrë. Më krijoi frymëzim edhe ngjarja e futbollistit të mirënjohur tani, egjiptianit Muhammad Salam, ku ai thotë që në lagje ku ka fusha futbollit rriten talentet. Kështu ka qënë edhe në fshatin tim shprehet ai... Dhe unë në Tëitter të tij e kam përshëndetur mendimin e tij dhe humanizmin e madh që po tregon për vendlindjen e tij (fshatin e tij). Dhe



vërtetë në lagjen Kiras, pranë liqenit, për 100 vite kanë luajtur në fushat e blerta të futbollit që natyra ja dhuroi kësaj lagjeje, “Saqe dhe Kurtina” ku trajneri popullor i lagjes Hasan Rama për 50 vite nxorri breza futbollistas kirasjanë që mbrojtën edhe ngjyrën e kombëtares shqiptare. Një gazetar i njohur më tha: - “Profesor! Rrugica me 5 lojtarë të kombëtares është një mrekulli, është si të themi për një çmimi “Guinness”, që këtë propozim duhet ta bëjë Federata Shqiptare e Futbollit, duke i afuar një historik të plotë të futbollit në Shkodër dhe në veçanti në lagjen Kiras.

Këto tre mrekulli që shpreha janë pre-

zantuar në mënyrë modeste edhe në televizionet lokale me përpjekjen e gazetares së njohur Kozeta Bruçaj, e cila është përpjekur të pasqyrojë këto tre mrekulli për ti afuar një historik real por edhe një mrekulli për Shkodrën si djepi i arsimit dhe i sporteve. Dëshira ime është që qeveria shqiptare duhet të rivlerësojë edhe njëherë shkollat profesionale sportive, në veçanti atë të futbollit për të hapur një shkollë të mesme këtu në Shkodër e aq më mirë në lagjen Kiras, ku ndërtesa shumë e madhe e ish shkollës veterianare mund të bëhet shumë mirë një shkollë e mesme sportive e futbollit. Ky do ishte edhe një realizim i dëshirave dhe ëndrrave të fut-

bollistëve të mëdhenj kirasjanë të kombëtares shqiptare të vitit 1946 si Xhevat Shaqiri, Bimo Fatja, Ahmet Nuti, Daut Shkreli, Bari Kavaja etj, të cilët gjithë jetën e tyre e lidhën me futbollin. Kur unë sot shkruaj me kujdes të madh për ecurinë e futbollit në qytetin tim kam të drejtë të them se edhe në këtë lagje mund të lindin lojtarë të mëdhenj dhe të talentuar që do ti japin jehonë re futbollit shqiptar. E kam të vështirë të them që ky shkrim bëhet në këto ditë kur Vllaznia është në krizë. Shpreh dëshirën që t’i jepet një zgjidhje e plotë kësaj skuadre të futbollit me tradita të shkëlqyera të sportit shqiptar, djepit ku lindi futbollit. Shkrimi im ka edhe një qëllim tjetër, për të sensibilizuar biznesmenët të mëdhenj në mbështetje të futbollit, në veçanti atë shkodran, si dhe sporte të tjera.

Pra këto ishin tre mrekullitë që ndodhin në Shkodër dhe që përbëjnë një vazhdë të traditës shqiptare në fushën e arsimit dhe të sportit.

Ky shkrim i kushtohet të gjithë sportistëve kirasjanë që dhanë për sportin shqiptar.

MUAMER VUCI

PSE ËSHTË LËNË NË HIJE GJON MARASHI I BRASHTËS SË SHOSHIT

Padyshim, një nga figurat me aktivitet shumë të gjerë patriotik e atdhetar, me të cilin duhet të krenohet i gjithë Dukagjini, është Gjon Marashi i Brashtës së Shoshit. Shtysë për të shkruar për te, më dha fakti se në dekadat e fundit janë bërë shumë këngë për Shoshin e Dukagjinin dhe megjithëse vargu i njerëzve që përmenden në to është shumë i gjatë, për të cilët nuk jam me dhënë vlerësimin se a e kanë merituar apo jo, nuk përmendet kurrkund Gjon Marashi.

Janë botuar disa libra dhe veprimtaria e tij pasqyrohet vetëm në librin e Prelë Milanit "Profesor Kolë Prela, deputeti historik i Dukagjinit", në të cilën Gjoni del si bashkëpunëtor i tij në luftën Nacional-Çlirimtare. Prandaj vendosa të shkruaj pak rreshta për te, jo për brezin e tretë, sepse ata e njohin direkt, apo kanë dëgjuar nga paraardhësit e tyre për bëmat e tij në shërbim të Atdheut, por për brezin e ri për t'ua paraqit madhësinë e këtij patrioti dhe atdhetari, i cili kurrë nuk u pajtua me asnjë lloj pushtuesi apo regjimi antipopullor. Ai luftoi i pa epur, me armë në dorë kundër tyre. Unë, si një pasardhës i brezit të lavdishëm, që bënë luftën Nacional-Çlirimtare, që pjesëtarë nga familja ime kanë qenë aktiv duke pasur në formacionet partizane gjithnjë komandant, Gjon Marashin, ndjej obligim që të kontribuoj sadopak për të shkund nga pluhuri i harresës dhe i mos vlerësimit të atyre që bënë historinë në mënyrë që dhe brezi i ri të dinë e të mësojnë sa më shumë për ta, t'i kenë burim frymëzimi në jetë.

Kush është Gjon Marashi?

Gjon Marashi, u lind në vitin 1896, në fshatin Brashtë, të krahinës së Shoshit, në një familje me tradita patriotike, pasardhës i trungut të Marash Tucit, nip në fshatin Lotaj, të krahinës së Shalës.

Ai, që në rini u edukua me ndjenjën e patriotizmit dhe të atdhedashurisë. Mori pjesë aktive në të gjitha momentet historike të gjysmës së parë të shekullit njëzetë. Ishte një patriot i pasqor, luftëtarë i lirisë për çlirim kombëtar. Edhe pse i ri, mori pjesë në kryengritjet për Pavarësi të viteve 1910-1912, sidomos në luftën e Qafës së Agrit. Shumë aktiv në zhvillimet e revolucionit të qershorit 1924, fanolist, përkrahës i Luigj Gurakuqit dhe mik i Bajram Currit. Ishte një antizogist i thekur, i cili ishte një ndër krerët e lëvizjes së Dukagjinit të vitit 1926 kundër Zogut, një kaçak i pa bindur kundër regjimit të tij bashkë me të vëllain, Mhillin, i cili u dënua me burgim të përjetshëm në mungesë. Ka qenë një ndër prijësit dhe ndër më aktivët në luftën e Gurit të Kuq kundër serbo-malazezve, në muajin prill të vitit 1941, megjithëse nuk kishte fort dëshirë me fol për këtë luftë. Gjatë luftimeve edhe është plagosur në përpjekje me austriaket. Ka qenë pjesëmarrës që herët në luftën e lavdishme Nacional-Çlirimtare. Më formimin e çetës partizane të Dukagjinit me 5 nëntor 1943, u caktua komandant i saj dhe me drejtues politik profesor Kolë Prelën, që te dy nga Shoshi

. Me 16 tetor 1944 u formua grupi partizan i Shkodrës, në të cilin komandant i çetës së dytë u emërua Gjon Marashi. Me formimin e Brigadës së njëzet e shtatë sulmuese (Br27S), me 29 nëntor të vitit 1944, si pjesëtar i batalionit partizan



"Perlat Rexhepi", u emërua komandant kompanie.

Në çdo detyrë që i është ngarkuar, është shquar për organizim e trimëri, që kanë treguar dhe tregojnë bashkëkohësit dhe dekoratat e marra, siç është ajo e trimërisë, e 40 vjetorit të çlirimit e të tjera.

Me çlirimin e vendit nga nazi-fashistët, për meritat e Tij gjatë luftës, i'u ngarkuan detyra të rëndësishme e të vështira në ish-rrethin e Dukagjinit si: Komandant i forcave të ndjekjes, postkomandant dhe kryetar i këshillit antifashist Nacional-Çlirimtare për Dukagjinin. Edhe pse autodidakt, në saje të përkushtimit dhe vitalitetit të tij, puna nuk i bënte vajtë. Diti të bashkëpunojë me njerëzit më të mirë të Dukagjinit, që kishin bërë luftën, duke bërë të mundur që shumë veprime të këqija të eliminohen pa pasoja. Ai, krahas Lekë Camës, shpëtoj shumë njerëz pa u eliminuar apo torturuar sidomos ata që kishin qenë në shërbim të pushtuesit apo kundërshtar të lëvizjes partizane. Pikërisht, për këto "zbutje", në vitin 1946 e transferuan në

Vlorë, në detyrën e komandant në sektorin ushtarak.

Menjëherë pas çlirimit mori pranë vetes të birin, Kolën, si njeri i shkolluar brenda e jashtë vendit, i cili kryente me devotshmëri detyrat që i ngarkoheshin

qendrorë, duke qenë me kuraja shumë të madhe, i cili e kishte derën e hapur me trokit në të gjitha zyrat e shtetit e partisë së kohës. Ishte edhe anëtarë i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

Kishte një pamje madhështore, si një kreshnik i maleve, me një trup të drejtë e të gjatë, të cilit ia shtonin hijeshinë edhe rrobat kombëtare, që i mbante gjithnjë veshur. Prandaj udhëheqësi i kohës e mbante afër në çdo ngjarje, siç ishte ceremonia e zhdukjes së pasojave të tërmetit, në muajin shtator 1979, dhe i referohej shumë herë në bisedat e tij edhe kur nuk e kishte pranë.

Ai kurrë nuk fliste për vete. Kishte dëshirë me fol për të tjerët, sidomos për bashkëluftëtarët e tij si: Balë Markun, Ndue Micanin e Toplanës, Martin Gjonin e Shalës e të tjerë bashkëkohës të tij. Ishte i thjeshtë e shumë i komunikueshëm, i jepte respekt çdo moshe e gjinie. Kurrë nuk përpiquej me përfitua nga shteti i kohës për interesa personale, me gjithë kredinë që kishte.

Ai, e kishte shumë të ndjeshëm e virtyt ne shpirtin e tij fisnik frymën e faljes e të pajtimit, nëpërmjet së cilës kontributi i tij ishte i madh. Këtë frymë u futi edhe në familjen e tij, e cila mbas 90-te e fali gjakun e të birit, Kolës, duke u bërë shembull për të gjithë Dukagjinin. Se sa zëmardh ishte e tregoj përcjellja që ju bë në gusht të vitit 1987, ku të krijohej përshtypja se nuk ka mbet njeri në Dukagjin e më gjerë pa marrë pjesë në lamtumirën e tij të fundit.

Fatkeqësisht, pas viteve nëntëdhjetë, në vendin tonë është ringjallur një frymë neofashiste duke mohuar luftën Nacional-Çlirimtare dhe duke mos vlerësuar ata që e bënë këtë luftë, apo ata që kontribuuan për ndërtimin e vendit tonë. Veprat monumentale e të gjithë atyre që luftuan çdo pushtues e bashkëpunëtor të tyre janë gurë themeli të Shqipërisë së pavarur e sovranë, që në këto themele është edhe kontributi i vyer i Gjon Marashit të Dukagjinit. Asnjë vlerësim për te apo të tjerë me veprimtari atdhetare para nëntëdhjetës nga pushteti vendor apo qendror, nga komiteti i veteranëve apo shoqatat e ndryshme.

Pse të kemi frikë për vlerësimin e tyre?

Asnjë fjalë nuk është thënë në tre dekadat e fundit për Shkurte Pal Vatën, e cila me heroizmin e saj mobilizoj gjithë rininë shqiptare dhe Dukagjini u elektrifikua dy vjet para pjesës tjetër të vendit nga frymëzimi i saj.

Shpresoj, se edhe shoqata Atdhetare "Dukagjini" të ja gjejë momentin që në të ardhmen ta vlerësojnë veprimtarinë e Gjon Marashit, me titullin "Mehmet Shpendi", si dhe krijuesit e disiplinave të ndryshme kulturore e artistike mos të përtojnë me e përmend emrin e tij në krijimtarinë e tyre, pavarësisht se pasardhësit e Tij nuk janë në gjendje me u interesua për te.

PRELË SHYTANI

AKULLORE FEST - 5

Festivali lokal për fëmijë "Akullore Fest" në Shkodër festoi 5-vjetorin e tij!

"Akullore Fest", ky festival i mrekullueshëm i këngës për fëmijë në Shkodër, sivjet në këtë fillim vere mbushi 5 vjet, si një vogëlushe e bukur, që dalëngadalë iu afrua kështu edhe moshës së artistëve të vegjël pjesëmarrës, pasi edhe ata në përgjithësi ishin të moshave shkollore të të dy cikleve.

Ky festival jubilar ishte menduar nga organizatorët dhe Shoqata Kulturore Artistike "Mark Kaftalli", të zhvillohej në sallën e Teatrit "Migjeni", por siç ndodh shpesh për mungesë fondesh, ai përsëri shpalsi bukurinë e tij në sallën e koncerteve "Gjon Kapidani" në tempullin e arsimit artistik, Shkollën e Mesme "Prenkë Jakova", të drejtuar nga maestro Anton Kaftalli, njëkohësisht edhe drejtor i kësaj shkolle.

Ishte një mbrëmje e mrekullueshme, një mbrëmje me zëra të gëzueshëm femitorë që kishin ardhur të performonin me bukurinë e luleve, me idenë e freskisë së akullores së shijshme, që në të vërtetë ishte lajtmotivi i asaj kënge të mrekullueshme që rreth 45 vite më parë u bë një këngë hit për gjithë fëmijët e Shqipërisë.

Në këtë shkrim e ndjeje dhe unë këtë freski, e ndjeje dhe unë këtë gjallëri, sepse kur rrinë pranë këtyre fëmijëve të mrekullueshëm, për pak kohë e ndjene dhe veten si ata.

Nuk ishin kushtet ideale për të realizuar një festival të tillë, por ishte dëshira e madhe për ta bërë këtë festival të 5-të të paharrueshëm për këto fëmijë pjesëmarrës. Për këtë u angazhuan të gjithë dashamirësit e këngës për fëmijë, muzikantë, poetë, orkestrues dhe prindër, të cilët ia arritën qëllimit. "Akullore Fest"-5, që festoi më së miri edhe këtë ditë lindje të saj.

Këtë rezultat e tregoi më së miri pjesëmarrja. U kënduan 17 këngë të reja nga këngëtarë gati-gati bashkëmoshatarë me këtë festival, me këngë të kompozuar dhe orkestruar edhe nga mësuesit e tyre dhe me një kontribut të autorëve letrarë të të gjithë qytetit të Shkodrës, që e ndienë për detyrë, që duhej të kontribuonin pikërisht për këtë festival.

Në këtë kontekst duhen lavdëruar të gjithë, pasi siç u shpreh në një media lokale drejtuesi i këtij festivali z. Anton Kaftalli, kjo veprimtari u realizua falas, falë mirëkuptimit që shkolla jonë dhe Shoqata e nderuar "Mark Kaftalli" ka me bashkëpunëtorët e nderuar dashamirës të talenteve të reja.

Këngët e Festivalit "Akullore Fest" edicioni i pestë u kënduan vetëm në një natë dhe salla e koncerteve e tej mbushur tregoi se kjo sallë, që ka një emër kaq të madh, do të jetë gjithmonë si një pranverë, që sjell lule të freskëta dhe akullores të shijshme.

Për vlerësimin artistik të krijimtarisë së festivalit ishte zgjedhur një juri shumë e nderuar dhe profesioniste, në të gjitha komponentët dhe duhen përmendur pasi janë personalitete të artit dhe kulturës shkodrane.

Këtë juri të përbërë nga Gazmend Kraja-dirigjent dhe Djana Bilali-këngëtare lirike, të dy mësues në Shkollën e Mesme Artistike "Prenkë Jakova" e kryesonte Zija Vukaj, mësues letërsie, shkrimtar dhe përkthyes, kryetar i shoqatës së shkrimtarëve Shkodër.

me libret të Lindita Cungut, udhëheqës artistik Zaim Mërkulaj e Artion Qamili dhe u prezantua me shumë dashuri nga dy moderatore, Alsoeda Bilali dhe Anisa Meshnuni, nxënëse të kësaj shkolle, që së shpejti mundtë i shohim edhe në prezantime të tjera, për të cilat qyteti



Çdo veprimtari artistike ka një prapavijë, ka një përkujdesje, ka një regji, por ka edhe një detyrë tjetër shumë të

ynë ka nevojë. Skenën e plotësuan me freskinë e akullores edhe dekori i realizuar nga «Art Dekor Hyseni», Shkodër.



rëndësishme, siç është prezantimi i tij. Të gjithë këta elemente ishin menduar dhe vlerësuar. Kështu që Festivali u realizua

Me dy fjalë duhet të ndalem te kontributi, që është pak të thuash i shquar i z. Anton Kaftalli, i cili në këtë edicion



mund edhe të dorëzohej, por me dëshirën dhe shpirtin e tij, si i thonë shkodoranët "Ja la vedit". Por duhen përmendur edhe përkrahësit e tij, mësuesit e talentuar Gazmend Kraja, Artion Qamili dhe Andi Unaza, si dhe gjithë stafi i shkollës.

Të organizosh një veprimtari artistik me krijimtari të reja duhet një investim, sepse ky festival investon talente të rinj, i zbulon dhe i fut ata në një rrugë drejt një të ardhmeje që nesër mund të bëhen krenari për qytetin dhe kombin tonë. Dhe këto kanë ndodhur. Me këtë rast duhet të vënë dukje se Drejtoria Rajonale Arsimore, institucionet për katë se të Bashkisë, e pse jo të Ministrisë së Arsimit e Kulturës, duhet të jenë më dashamirës me këto veprimtari që jo vetëm zbulojnë talente të reja, por edhe gjallërojnë jetën artistike të fëmijëve, e cila mendoj se është një problem me të cilin duhet të merremi të gjithë.

Festivali "Akullore Fest" edhe kështu si u realizua ishte jashtëzakonisht i bukur.

Të gjithë fëmijët në skenë ishin indiferent për të gjitha problemet. Të gjithë këndonin dhe kërcenin si në një festë në shkollën e tyre, por natyrisht disa ishin më të mirë dhe morën çmimet e tyre.

Kështu me çmimin e parë u vlerësua kënga "Tomi dhe xherri, teksti Lindita Halili, muzika Anton Kaftalli, kënduar nga Danjela dhe Elena Babani, shoqëruar nga kori i fëmijëve.

Me çmim të dytë u vlerësuan këngët "Si lule po rritem", teksti Ramazan Çeka, muzika Vera Kaftalli Çuni, kënduar nga Klara Daberdaku dhe kënga "Lepurushi paska vapë", teksti Bruna Gajtani, muzika Oleg Gjergo, kënduar nga Estera Ndreka.

Me çmimin e tretë u vlerësuan këngët "Këndesi topolak", teksti Qazim Çela, muzika Edi Mërkulaj, kënduar nga Marko Kaçi, "Mos i kurseni fjalët", teksti Meri Guli, muzika Roland Guli, kënduar nga Kejsi Bushati dhe "Kuqezinjtë e vegjël", teksti Osman Kozmaj, muzika Ares Fani, kënduar nga Rajan Fani.

Këngëtarja më e vogël e Festivalit, vogëlushja 3-vjeçare Shejhdina Zoga, me këngën "Kukulla ime", teksti Lindita Cungu dhe muzika Klinsman Llazani, u vlerësua me çmimin e kurajës si e ardhme e këngës për fëmijë.

Festivalin e përshëndetën edhe fituesit e edicioneve të kaluar të "Akullore Fest" si; Kristi Ndoja, Rigersa Loka, Angjelo Preçi dhe Odesa Meti.

Për kontributin e tyre të shquar në krijimtarinë e këngëve për fëmijë, në këtë festival jubilar, u nderuan me "Çertifikatë Mirënjohje", kompozitori i palodhur Oleg Gjergo dhe poeti Ramazan Çeka.

"Akullore Fest" 5 u pasqyrua në mediat televizive lokale, jo vetëm si një lajm, por si një eveniment shumë i rëndësishëm në jetën artistike të fëmijëve në Shkodër, që kërkon gjithmonë vëmendje.

Dua ta mbylli këtë shkrim me një fale nderim të jashtëzakonshëm për prindërit e këtyre fëmijëve, sepse ashtu siç ka ndodhur gjithmonë në Shkodër, ata do të kontribuojnë që ta mbajnë gjallë Festivalin e "Akullores" në çdo brez që do të vijë.

Nga RAMAZAN ÇEKA

Malësia e Madhe nderon akademikun e shquar, Rexhep Qosja

Në një prani, aspak të zakonshme, me qytetarë dhe përfaqësues institucionesh, me shkrimtarë dhe artistë, me politikanë dhe përfaqësues nga rrethe letrare, apo akademike nga Shkodra dhe Malësi e Madhe, ku duhet shënuar prania e Ministrit tonë të Jashtëm, z. Ditmir Bushati dhe e dy ambasadorëve shqiptarë, atij të Kosovës në Shqipëri, sikurse e ambasadorit shqiptar në Kosovë, deputetit të Malësisë së Madhe, z. Paulin Sterkaj, apo e rektorit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës e të tjerë, e të tjerë. kryetari i Bashkisë Malësisë së Madhe, z. Tonin Marinaj, mori fjalën e hapjes dhe të nderimit ndaj Prof. dr. Rexhep Qoses, me rastin e dorëzimit të titullit "Qytetar Nderi i Bashkisë së Malësisë së Madhe" që Këshilli Bashkiak i kishte dhënë akademikut të shquar Prof. dr. Rexhep Qoses. Natyrisht një ditë si kjo do të vinte si shenjë ogurmire e kthimit drejt vlerave identitare, jo thjesht si trevë, por ajo më thelbësorja si komb, edhe pse gjithçka do të merrte jetë në mjedisin e bashkisë më skajore të vendit, Malësisë së Madhe. Do të ishte pikërisht 9 qershori 2018 që do të kujtohet gjatë në memorien e kësaj treve, jo thjesht, pse u dha një titull, sepse për të tillë, mjerisht, nuk po vuajmë, por thelbësorja, sepse do të vinte si standardi real, më kuptimplotë i një integriti, konkret brenda vetvetes të kësaj treve, ndryshe në veçanti i malësorëve. Ndonëse nuk do të ishte në staturën e një vlerësimi akademik, nderimi i birit të Kelmendit, birit të Malësisë së Madhe, Prof.

doktor Rexhep Qoses, veprimtaria do të tregonte nderin që kjo tokë u jep bijve të saj, të shquar, siç do ta cilësonte, mjaft bukur, Ministri ynë i Jashtëm, z. Ditmir Bushati, momentin solemn të dhënies së titullit "Qytetar Nderi i Bashkisë së Malësisë së Madhe", akademikut të shquar Prof. dr. Rexhep Qoses, identiteti krijues i të cilit do të vinte mes nesh si identiteti i vlerave më elitare të kombit tonë. Kjo, sepse sot Rexhep Qosja, me dinjitet profesional, mund të konsiderohet si rilindësi i kohës sonë, ndryshe Naimi i ditëve tona. Qosja, shkrimtari, studiuesi, historiani i letërsisë shqipe, kritiku i shquar letrar, po aq sa romancier dhe intelektual, polemisti dhe atdhetari më elokuent i kohës sonë duke u bërë pjesë substanciale e debatit të mirënjohur Kadare-Qose mbi identitetin tonë kombëtar, jo thjesht do të spikaste për vizionin dhe argumentin e shquar profesional, historik, etik dhe filozofik, por mbi të gjitha do të shpaloste domethënien e plotë të atij identiteti, si vlerë diversiteti, larg mitomanisë, falë sjelljes sonë tradicionale: sa folklorike, jashtë kohe, sa të politizuar, në kontekstin posthistorik, që jetojmë, një frenato reale, në rrugën e emancipimit tonë kombëtar. Si njëri nga shkrimtarët dhe kritikët tanë të shquar, si historian mjeshër i letërsisë shqipe, sidomos asaj të epokës së romantizmit, po aq si polemisti dhe publicisti i rrallë në jetën e kombit tonë, me personalitetin e tij madhor, si bir i trevës së Malësisë së Madhe, së cilës do t'i jepte përfaqësim dhe rreza-

tim elokuent, sa real, sa virtual, në një përmasë vizioni bashkëkohor, falë një imazhi në kompleksitet, trevës që sot e priti dhe e nderoi si djalin e saj, të ndritur, ndryshe si njëra nga mënyrat më elegante të nderimit të vetvetes. Kam pasur rastin ta njoh fare i ri veprimtarinë e jashtëzakonshme, krijuese, gjuhësore, stilistike, estetike dhe publicistike të akademikut Rexhep Qosja, qoftë si romancier, qoftë si kritik letrar, qoftë si studiues serioz, qoftë si intelektual i përmasave kombëtare, por njohja e drejtpërdrejtë me të, në Javën festive të Pavarësisë së Kosovës, ku pati rastin të jem i ftuar si kritik letrar, në atë veprimtari të paharruar, shkurt 2008-ës, më ka befusuar për përmasën e kulturës totale, letrare, gjuhësore, politike, patriotike, si vlera identitet, krahas guximit qytetar, sinqeritetit të fjalës si intelektual dhe si një shqiptar i madh, bir i Malësisë së Madhe, që dallon bindshëm për argumentin dhe ndershmërinë e vizionit të tij, realist: sa estetik, sa politik, sa patriotik. Qosja është shqiptari më i guximshëm dhe i drejtpërdrejtë i kohës sonë që, po aq sa nderon vetveten me përkushtimin e tij intelektual dhe patriotik, euroatlantik, po ashtu nderon dhe e do Shqipërinë Natyrore si një e drejtë universale, ndryshe si standardi më demokratik i peshës së fjalës së lirë, larg shtirjes filozofike, apo hipokrizisë civile, kur ne, mjerisht, drejtpërdrejt apo në formë të tërthortë, kemi mbetur nën ethet e politizimit idiot, kultpragmatizmit banal, aq sa edhe konceptet: integritim, evropianizim, reformim, e të tjerë i përcjellim nën ethet e entuziazmit modern, krejt si dje, nën ethet e optimizmit të madh. Qose shkëlqen me penën e tij, që me të drejtë cilësohet si arma më pragmatiste dhe më efektive e mendjes së tij të ndritur, kur mjerisht shumë e shumë "pena" e "personalitete" nuk guxuan, as nuk po guxojnë të thonë lirshëm: Sa dua vetveten të

lirë, kurrësi të gjymtuar, po aq dua edhe Shqipërinë time, të lirë e të plotë, ashtu siç na e dhuroi natyra, pra jo të cunuar, londineze, nuk dua as kënd në këtë botë. Slloganomania, si shprehja më e sofistikuar e hipokrizisë civile, në realitetin postmodern gjithë shqiptar, ka qenë dhe do të jetë kurdoherë objektivi i goditjes sistematike qosjane, kundër sjelljes hipokrite, të shtirur, ndaj vlerave euroatlantike, që na kërkohen të dëshmojmë, larg partitokracisë që vijon të mbajë peng pozicionin e kthjelltë të klasës sonë politike.

Pikërisht për të gjitha këto, që shpreha nga pozicioni i të ftuarit si kritik letrar dhe kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve dhe artistëve, të Malësisë së Madhe "Nderi i kombit", së bashku me kryetarin e Shoqatës së shkrimtarëve, Shkodër, përkthyesin e njohur, z. Zija Vukaj, gjykova ta them publikisht vlerësimin tim, sepse me aktin që sot realizoi Këshilli Bashkiak i Malësisë së Madhe dëshmoi për një trevë vërtet të Madhe në domethënien e saj filozofike, që di të nderojë figura të përmasave, madhore, vërtet të pakicës, si elitare, por të paharruara në histori nga memoria e shumicës si popull, si akademiku i shquar, Rexhep Qosja, paçka se opozita jonë demokratike në Këshillin Bashkiak, mjerisht, pati braktisur sallën në ditën e vendimarrjes për dhënien e titullit të lartë, djalit të shquar të Malësisë së Madhe "Nderi i Kombit", të Madhit Qosja. Po ashtu Qosja me fjalën e Tij, gjithë emocion, respekt dhe mall të pushuar ndaj trevës së Malësisë së Madhe, manifestoi mirënjohjen, shpirtin e intelektualit, krijuesit dhe patriotit të madh për trevën që e nderoi, në një ditë solemniteti për të dhe gjithë malësorët e kësaj treve, si kjo e sotnja.

Kadri Ujkaj,

kryetar i shoqatës "Shkrimtarët dhe artistët, Malësia e Madhe"

MALËSIA E MADHE BUJARE ZEMËRMADHE, NUK KA KURRFARË KUPTIMI TË PËRGOJOJË QOSEN E MADH!




**Nga
Prele Milani**

Aq shumë është abuzuar me titujt dhe dekoratat e nderit në Shqipëri sa të dukën si prerje estetike liretash te dala jashtë qarkullimit me

euros!

Nuk mund të thuhet kështu për rastin konkret. Qosja është i Vuthaj. Në Dukagjin kurë vihej në pah një person i thoni "Si me kenë djalë Vuthajsh!" Vuthajt janë gjymtyre organike e Kelmendit, Kryefjalës qëndrestare të Malësisë së Madhe.

Në statistikën e sfidave historike të Malësisë së Madhe, Kelmendi është si Reali i Madridit në Çempjionat ndaj Barcelonës (Hoti e të tjerëve). Edhe Rex-



hep Qosja është një Ronaldo në krahasim me figurat e tjera shumë të nderuara të dimensioneve kombëtare që nënvizon me germa kubike zoti Ejll Miculi. Qosja është një mal në vargun letrarëve shqiptarë, nuk është as engjell i pa përluter, as djall që ruajna Zot prej ti!

Personalitet të kalibrit të tillë janë pa dyshim poliedrik dhe kompleks si viti me katër stinë. Nuk mallkohet me vrer gjithë motmoti për disa javë me borë e murrllan ose stuhi e vetëtima. Kreshtat nuk shpëtojnë dot prej mjegullave dhe reve reshje ndaj na duken të zymta e të egra, por kur

kthjellohet moti e lindë dielli kreshtat rrezatojnë hijeshi, krenari dhe madhështi.

Fytyra e rrudhosur e Qoses si lëvozhgë bungu të vjetër mbuluar me myshk, është vetë jeta dhe historia e tij dhe kombit të tij. Në fushën e letrave qose ka bërë më të mirën që mund të bëjë një akademik për vendin e vet. Nuk ka shkëlqyer në politikë pasi lisa harmoq të tillë nuk mund të shtien rrejë moçalishte. Pyetja retorike: Çfarë beri Qosja për Malësinë e Madhe?, - më duket intriguese dhe pa vend. Mos vallë Qosja do vinte të shtrojë trotuaret e Koplikut apo ngre një shtëpi kulture në Malësi të Madhe, ose t'u gjej treg për duhanin dhe bimët medicinave.

Malësia e Madhe me zemër dhe bujari të madhe, nuk ka kurrfarë kuptimi të përgojë Qosen e madh për një falënderim kaq modest e simbolik si dekorata që mori dje. Ma do mendja se Zoti Tonin Morinaj e ka aq integritet sa nuk kishte nevojë të merrte lejen e "Zotave" për një atribut që i takon Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë që drejtohet nga ai.

Pasionet Politike në Shqipëri akoma edhe pas 28 vitesh mbetën droga më e fortë me pasojë akute për mendimet dhe qëndrimet tona, duke arritur deri në përbaltje ndaj çdo të gjalli e të vdekuri. Kush hell vickla në drejtim Qose gabon, pasi Veleçiku nuk shkapërcehet me guralecë.

Përse burrat i dhunojnë gratë

Burrat do të ishin shumë më burra nëse, nuk do të mundoheshin të tregonin, sa burra janë. Nuk janë aq sa tregohen. Janë shumë më të dobët nga sa duken dhe tregohen. Pika më e dobët e tyre është, mungesa e kontrollit mbi vetëveten. E kanë shumë të vështirë që t'i vënë nënkontroll impulset e dhunës. Psikologët mendojnë se, 50 për qind e konflikteve midis burrave, të cialt përfundojnë në dhunë, deri në marrje jete, shkaktohen për gjëra vulgare, motive të dobëta. Rol shumë të madh luan mjedisi, familja, të afërmit dhe shoqëria, në sytë e të cilve, burri duhet të tregohet burr. Tek meshkujt, pas një ligësie, gjithmonë fshihet një dobësi, një pikë e dobët. Shumë burra vuajnë nga ndjenja e inferioritetit, e mendojnë veten të dobët. Burrat që vuajnë nga një ndjenjë e tillë, ndjehen keq para një gruaje konkrete si dhe para njerëzve të tjerë, aty ku nuk përfillen dhe humbasin krenarinë mashkullore. Ata nuk e durojnë dot një status të tillë dhe mundohen ta kompensojnë me një sjellje apo veprim agresiv. Një burr i vetëdijshëm, kryalartë, nuk dhunon kurrë, nuk ka nevojë ta bëjë një gjë të tillë. Shumë meshkuj karakterizohen nga mungesa e madhe e fleksibilitetit, janë shumë të ndjeshëm. Nuk duhet menduar se burrat janë më të ndjeshëm se gratë por, kur është fjala për natyrën e tyre mashkullore, ata janë të padurueshëm. Nëse i thuhet një burri se “ti nuk je gjë si burr”, është shumë më e rëndë për burrin se sa për gruan, nëse i thuhet asaj, “ti nuk je gjë si grua”. Burri që nuk është i sigurtë në burrërinë e vet, është shumë i rrezikshëm për gruan. Në të gjitha rastet kur burri përdorë dhunë mbi gruan, e mendon veten poshtë saj, pozicion të cilin ai nuk e duron dot. Nuk e duron dot femrën “hundëpërpjetë”. Dhuna seksuale, në shumë raste, nuk ka të bëjë me dëshirën për seks por, shumë më tepër, për t'ia ulur hundën një gruaja ose për të poshtuar burrin e saj. Kjo ka shpjegimin e vet nga ana psikologjike: Mashkullorja, për psikozën e burrave, është gjëja më madhore. Burrat studjohen si meshkuj kur ndahen përfundimisht nga gjinia femërore (në moshën e pubertetit). Ndjenjat dhe sjelljet femërore, të cilat gjenden në natyrën e tyre, duhet t'i manipulojnë vetë pasi nuk i shkojnë natyrës mashkullore dhe i mendojnë rrezik për identitetin e tyre. Kjo fillon që në moshën femërore ku djemtë tregohen “harbut” me nënat, solidarizohen me etërit (solidaritë mashkullore), përçmojnë gjininë tjetër (motrat), sillen si homofob. Djali mendon: *Unë dhe babi, jemi njerëzit më të rëndësishëm këtu*. E thënë shkurt: Mashkullorja bazohet në mospranimin e femërores. Me këtë princip, angazhohen të gjithë meshkujt dhe pjesa më e madhe ia dalin. Të tjerët vuajnë dhe i bëjnë edhe të tjerët, kryesisht femërat, të vuajnë. Për burrin, tri gjëra janë jetike: Pushteti, paraja, seksi. Nga të tria këto, më e rëndësishmja është pushteti. Çdo mashkull, të

paktën diku, endrron të jetë i plotpushtetshëm. Nëse nuk ia del jashtë familjes, ai

alisht ata pësojnë çrregullime të mëdha të personalitetit. Ndër të tjera, semuren nga



e provon këtë në familje, me gruan dhe fëmijët. Nëse edhe aty dështojnë, vuajnë nga ndjenja e inferioritetit. Pavarsisht nga sjellja e gruas, meshkujt që vuajnë nga ndjenja e inferioritetit, nuk ndjehen kurrë të sigurtë. Kjo nuk është vetëm në jetën bashkëshortore. Burri mund të ndjehet i poshtëruar edhe në punë, nga shefi apo kolegët, në raste humbje apo të frikës së humbjes, të frikës së rënjes në situata të vështira. Situata të tilla mund t'i shkaktojnë ndjenjën e hakmarrjes. Të gjithë meshkujt, pavarsisht nga mosha, funksioni dhe shkollimi, mund të përjetojnë situata të tilla. Nuk ka asgjë për tu çuditur nëse në ekranin e televizorit shikojnë një personalitet të njohur, tani si autor krimi, në familje apo diku tjetër. Ata verbohen para një iluzioni, e marrin atë për të vërtetë dhe ... gruaja e tij por, dhe dikush tjetër, e paguan me shëndetin apo dhe jetën. Meshkujt që nuk e ndjehen veten burr në nënlëkurën e tyre, përbëjnë rrezik, për veten e tyre dhe të tjerët. Më të rrezikuara nga të gjithë janë gratë dhe vajzat e tyre. Gradu-

ndjenja e xhelozisë. Semuren aq rëndë sa, nëse nuk e gjejnë “dashnorin” e gruas, fiksojnë njërin dhe, fap, ia merr jetën atij ose gruas. Të vrasin për një shikim, për një buzëqeshje, për një përshendetje. Burrat që vuajnë nga ndjenja e hakmarrjes, edhe pas ndarjes me bashkëshorten, nuk e lënë kurrë të qetë atë. E ndjekun nga pas, trillojnë gjëra të paqëna me qëllim që ta diskreditojnë në sytë e të tjerëve. Përpiqen ta rrenojnë përfundimisht.

Një burim tjetër i dhunës së burrit mbi gruan është kultura e egër, barbare, e trashëguar dhe kultivuar ndër shekuj. Është kultura ku gruaja mendohet send, që i takon një burri me të cilin ai mund të bëjë çfarë të dojë dhe sillet si të dojë. Në Gjermani, në vitin 2017, një azilant afrikan, Hussein K nga Afganistani, e perdhunoi seksualisht dhe e vrau një studente gjermane, Maria L, nga Freiburg. Kur kryetari i trupit gjykues, i deklaroi atij vendimin gjyqësorë, *burgim të përjetshëm* ai tha: Çfarë demokracie është kjo e juaja? Si mund të denohet njeriu me

burgim të përjetshëm për një gjë të tillë? Unë një femër vrava! Kjo është kultura e tij barbare, orientalo-patriarkale lidhur me qëndrimin ndaj femrës. Por, sigurisht që jo vetëm personalisht e tij. Është edhe e kombit nga i cili ai vjen. Mjerisht, kombi ynë, është pjesë e kësaj kulture. Shumë nga ne e kujtojmë dramën me titull “Fisheku në pajë” të dramaturgut tonë, Mjeshtrit të Madh, Fadil Kraja. Meshkujt e edukuar në mënyrë patriarkale, me një kulturë përçmuese deri dhe armiqsore ndaj gruas, nuk mund ta kuptojnë gruan. Politologu me prejardhje siriane, Taip Bassam, profesor në universitetin e Goetingenit-Gjermani, thotë: *Duket se perëndimorët nuk e kuptojnë dhunën kundër grave në botën islame si traditë të një kulture orientalo-patriarkale. Në Orient, gruaja nuk mendohet subjekt por, thjeshtë si send që, ben pjesë në nderin e burrit*. Një ide e tillë, gëzon një popullaritet të madh edhe tek ne, në kulturën tonë. Ajë që e bën të “padukshme” dhunën tek ne dhe që i jep jetëgjatsi asaj, është frika e denoncimit të dhunës mashkullore nga gratë. Gratë heshtin, nuk guxojnë të denoncojnë dhunën. Nëse rrihet nga burri dhe duken qartë shenjat e dhunës, ajo thotë: *Jam rrëzuar nga shkallët*. Janë faktorë të ndryshëm që ia diktojnë një sjellje të tillë. Sipas kulturës tonë, viktimat femër, në të gjitha, rastet mendohet turp dhe agresori nuk gjykohej, ne opinoin. Një zakon i tillë, orientalo-patriarkal, ia mbyll gojën gruas edhe në rastet e perdhunimeve seksuale. Ajo, për të mos mbajtur turpin, fshehë dhimbjen, poshtimin e përjetshëm. Burrat e dijnë këtë gjë dhe i kanë duart e lira në sulmin ndaj grave. Problemi botrorë sot është përdhunimi seksual masiv i grave në vendet e luftës. Jemi dëshmitarë të përdhunimeve të tilla në Bosnie, Kosovë, Kongo dhe sot në Siri. Një sjellje e tillë kriminale, ka një motiv krejt tjetër. Lufta është

barbarizëm dhe si e tillë, agresori, për të arritur qëllimin, përligj çdo mjet. Përdhunimi seksual i grave është pjesë e taktikave të luftës. Është e organizuar nga lart. Edhe nëse dikush nga ushtarët e forcave pushtuese nuk dëshiron ta bëjë një gjë të tillë, ai është i detyruar. Me këtë agresori do t'i tregojë viktimës se: “Çfarë burrash jeni ju! Ju nuk mbronin dot gratë tuaja!” Pra, është akt poshtimi dhe hakmarrje. Me këtë, agresori don të tregojë edhe faktin se, mua më takon gjithçka këtu. Burrat e grave të perdhunuara, sigurisht që ndjehen shumë keq. Aq keq sa shumë nga ata bëhen gati të hedhin armët dhe të pranojnë vullnetarisht pushtuesin. Përdhunimet seksuale nga agresori arrijnë deri aty sa, aktet e perdhunimit, i kryejnë në prezencë të personave të tjerë, madje edhe të burrave, fëmijëve dhe të afërmëve të gruas viktimë. Duket se, përballë një barbarizmi të tillë, të gjitha organizmat ndërkom-bëtare, janë të pafuqishme.

Lekë Imeraj
shkrimtar dhe përkthyes

U nda nga jeta, gazetaria Suzana Dibra, ikonë e Radio Shkodrës

Ndonëse pritej të jetë në studion e lajmeve të Radio Shkodrës, në edicionin e radhës të lajmeve, një atak kardiak i mori jetën në moshën 62 vjeçare gazetares e falses së Radio Shkodrës, Suzana Dibra.

Kame pasur fatin, që në hapat e para të gazetarisë ta njohë nga afër, kur punoja si korrespondenti Radio Shkodrës. Ndi-hma profesionale që jepte për korrespon-dentet ishte me shumë nivel profesional.

Për hire të vërtetës, për shumë vite Radio Shkodra ishte mjaftë e dëgjuar dhe ishte i vetëm informacion për kohën. Zëri brilant i saj ishte i pranishëm në çdo familje Dukagjinase. Për 40 vite ishte e pranishme në redaksinë e radios.

Familjaret, koleget gazetar e miq, morën pjesë në homazhet e zhvilluar në hollin e Radio Shkodrës, me 1 qershor



2018, ku ishte i pranishëm dhe N/ drejtori RTSH Martin Leka. Në emër të gazetës "Dukagjini" i shprehe ngushëllime familjes dhe gjithë gazetarëve! Qofsh e pa harruar!

Zef Nika, Bruxelles

Zbulohet një qytet antik i shekulli të III para Erës Sonë, në Bushat

Maj 30, 2018

Një ekspeditë arkeologjike Shqiptaro-Polake ka zbuluar një vendbanim antik në zonën e Bushatit në Bashkinë e Vaut të Dejës.

Bëhet fjalë për një vendbanim që besohet se daton në shekujt III e II para Erës Sonë.

Sipas drejtuesit të kësaj ekspedite, profesor Saimir Shpuza, në këtë zonë nuk është bërë asnjë gërmim arkeologjik që në vitet '80.

"Materiali që kemi gjetur kryesisht na ndihmon për të identifikuar kuadrin kohor. Për momentin flasim për një periudhë të lulëzuar helenistike, nga shekulli i tretë deri në shekullin e parë Para Erës

Sonë", shprehet profesori Saimir Shpuza.

Sipas profesorit polak, pjesë të ekipit duket se kemi të bëjmë me një qytet të panjohur, të cilin shpresojnë ta identifikojnë së shpejti.

"Interesante është se ndodhet në një distancë të afërt nga Shkodra dhe Lezha. Muri i fortifikimit është shumë madhështor, 3 metra e gjysme i gjerë. Nuk e dimë ende emrin antik të këtij qyteti, por jemi të sigurt se është një qytet i panjohur më parë", shprehet Piot Dyczek.

Zbulimi në fjalë, përveç rëndësisë arkeologjike dhe mundësisë për zhvillimin e turizmit, pritet të sjellë informacione mjaft të vlefshme për qytetërimin e hershem të zonës.

Korrespondenti i gazetës "Dukagjini"



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:

NDUE FTONI

